

05

UDHËZUES XHEPI
PËR SIGURINË

Lidhja e Bombulave të Gazit

MESSER 
Gases for Life



Të nderuar konsumator të gazeve Messer

Messer prodhon dhe furnizon një portofol të gjerë produktesh dhe gazesh për bombula. Trajtimi i gazeve është i sigurt - për sa kohë që i kushtoni vëmendje vetive të tyre të veçanta.

Gazi në bombula është nën presione të larta deri në 300 bar. Mund të jetë gjithashtu toksik ose shumë reaktiv. Prandaj, sigurohuni që të njiheni me vetitë e gazit në bombulën tuaj të gazit të kompresuar. E njëjta gjë vlen edhe për rreziqet që lidhen me të.

Ky udhëzues xhepi ju jep informacione dhe këshilla se si të lidhni bombulat e gazit në mënyrë të sigurt.

Parimisht duhet të respektohen rregulloret përkatëse ligjore. Ne ju rekomandojmë që ta mbani gjithmonë afër Udhëzuesin e Xhepit.

E rëndësishme

Ju do të merrni një fletë me të dhënat e sigurisë me të gjitha informacionet e rëndësishme të sigurisë, për çdo produkt. Prodhuesit e reduktorëve të presionit ofrojnë udhëzime për përdorim të cilat përmbajnë gjithashtu informacione për sigurinë. Ju lutemi njihuni me këtë informacion.

Ekipi juaj Messer




"Specialistë" për detyra dhe gaze të ndryshme

Reduktorët e presionit mund të përdoren për të ulur presionin e bombulave të gazit, për të vendosur presionin e dëshiruar të punës dhe për ta mbajtur atë konstant. Kjo arrihet nga një mekanizëm i cili në thelb përbëhet nga një sustë rregulluese, një diafragmë, një kunj presioni, një sustë mbyllëse dhe një prizë valvule.

Reduktorët e presionit me dy faza janë ideale për arritjen e një presioni veçanërisht konstant në rrjedhën e poshtme. Në parim, kjo përfshin dy reduktor presioni me një fazë në seri. Në këtë rast, i pari fiksohet dhe rregullon

presionin e gazit të bombulës deri në rreth 25 bar. Kështu, i dyti mund të funksionojë me një presion paraprak relativisht konstant, i cili nuk ndikohet ose ndikohet pak nga presioni i bombulës.

Nëse kërkohet kontroll i vazhdueshëm i rrjedhës, si kur CO₂ përdoret si gaz mbrojtës për aplikimet e saldimit, ka **reduktorë të posaçëm të nxehtë të presionit** ose **ngrohës të veçantë** që parandalojnë ngrirjen e reduktorit të presionit.



Cili reduktor presioni për cilin aplikim?

Përgjigja për këtë pyetje varet nga tre faktorë kyç:

- Sa është presioni i bombulës së gazit?
- A është miratuar reduktori i presionit për gazin në fjalë?
- Në çfarë diapazoni duhet të rregullohet presioni i kundërt ose shpejtësia e rrjedhjes?

Për të parandaluar përdorimin e gabuar të reduktorëve të presionit dhe për të shmangur konfuzionin, **gazet e ndryshëm kërkojnë lidhje të ndryshme.**

Për shembull, bombulat e gazit për acetilen lidhen me anë të një lidhjeje me kllapa.



Kundërvindhë lidhëse për gaze të djegshme me brazdë



Kundërvindhë lidhëse për gaze të djegshme pa brazdë

Për bombulat e gazeve të djegshëm, lidhjet e ndryshme kanë **një fije në të majtë**, ndërsa të gjitha bombulat e tjera kanë **një fije në të djathtë**. Reduktorët e presionit për gazet e djegshëm mund të identifikohen gjithashtu nga **një brazdë në kundërvindhë lidhëse.**

Siguria që në fillim

Përpara montimit, kontrolloni reduktorin e presionit për pikat e mëposhtme:

- Është ngadalësuar susta e pozicionimit?
- A janë lidhjet e valvulës së bombulës dhe reduktorit të presionit **absolutisht të pastra, në gjendje të mirë dhe pa grimca papastërtie** apo edhe vaj ose yndyrë?
- A janë **vulat** në **madhësinë e duhur** dhe **të padëmtuara**? (Kjo vlen veçanërisht për unazat O në reduktorët e presionit 300 bar.)
- Rondelë e dëmtuar? Zëvendësoheni menjëherë me **një pjesë rezervë të përshtatshme origjinale** (vula të tjera "të përshtatshme", për shembull nga sektori sanitar ose automobilistik, janë të rrezikshme dhe nuk lejohen.)



Hap pas hapi



Përpara lidhjes

Fiksoni bombulën e gazit dhe më pas hiqni kapakun e shishes. Përpara se të montoni reduktorin e presionit, hapni shkurtimisht valvulën e bombulës për të **larguar çdo papastërti** që mund të jetë e pranishme. Fluksi që do të lëshohet duhet të drejtohet në hapësirë boshe.

Vidhosni reduktorin e presionit

Reduktorët e presionit me 300 bar mund të shtrëngohen me dorë, të tjerët kërkojnë mjete. Udhëzimet e përdorimit për reduktorin e presionit japin informacion për këtë dhe gjithashtu tregojnë se sa i lartë mund të jetë **maksimumi i fuqisë përdredhëse që shkakton rrotullim duke arritur shtrëngimin (maximum tightening force)**. Si rregull, mos e shtrëngoni tepër!



Hapja e ventilit

Hapni ventilat e bombulës **ngadalë** për të shmangur një rritje të papritur të presionit. **Një kthesë e plotë** është e mjaftueshme. **Kontrolloni** lidhjen e reduktorit të presionit për rrjedhje.

Ndaloni punën

Mbyllni të gjitha ventilat përpara pushimeve më të gjata në punë, pasi **rrjedhjet mund të shkaktojnë lëshimin e gazit në mënyrë të pakontrolluar**. Ju lutemi gjithashtu respektoni rregullat përkatëse të shëndetit dhe sigurisë në punë.



Eliminimi i ngricjeve

Për shkak se gazet janë nën presion të lartë dhe zgjerohen gjatë trokitjes, mund të krijohen ngricje në valvul. Këto mund të hiqen me **ajër të ngrohtë**, për shembull, por **kurrë mos përdorni mjete që ndizen prsh çakmak!**

Hiq reduktorin e presionit

Mbyllni valvulën e bombulës, **shfryni** gazin e mbetur ose **lëreni të rrjedhë jashtë**, më mirë përmes valvulës së lëshimit të presionit. Matësat e presionit në rrjedhën e sipërme dhe të poshtme nuk duhet të tregojnë më presion. Më pas lironi me kujdes reduktorin e presionit. Mund të ketë ende **presion të mbetur**. Nëse keni dyshime, fillimisht tendosni plotësisht sustën e çelikut në dorezën e rregullimit dhe më pas lironi përsëri.

Aspektet qendrore të trajtimit të reduktorëve të presionit

- Lexoni udhëzimet e sigurisë për gazet dhe reduktorët e presionit.
- Bëni kujdes me gazet veçanërisht ato reaktivë si oksigjeni ose acetilen.
- Valvula e bombulës dhe reduktori i presionit duhet të jenë të padëmtuara, absolutisht të pastra dhe pa vaj ose yndyrë.
- Susta rregulluese duhet të lirohet përpara se të lidhni dhe hiqni reduktorin e presionit.





Ju mund të kërkoni **Udhëzues** shtesë **Xhepi për Sigurinë** në faqen tonë të Internetit ose t'i merrni ato direkt nga ekspertët tanë.

E rëndësishme

Ky Udhëzues Xhepi përmban vetëm informacione të përgjithshme. Nuk zëvendëson trajnimet dhe nuk është menduar si i tillë. Messer nuk mban përgjegjësi për informacionet që përmban kjo broshurë.